



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:131539

Datë: 10.05.2024

Numri i dokumentit: 05669907

C. nr. 444/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Artan Abazi, në çështjen juridike kontestimor të paditësve – propozuesve të sigurimit I.K. dhe R. K., që të dy nga të cilët me autorizim i përfaqëson Selmon Sadiku, avokat nga Kamenica, kundër të paditurit – kundërshtarit të sigurimit Q. K. nga, me objekt kontesti për anulimin e kontratës së dhurimit të paluajtshmërive LRP.nr.077/24, me vlerë të kontestit prej 4.900.00 euro, me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, jashtë seancës gjyqësore, më datën 10.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I APROVOHET si i bazuar propozimi i paditësve – propozuesve të sigurimit I. K dhe R. K., që të dy nga dhe **CAKTOHET MASA E PËRKOHSHME E SIGURIMIT** dhe i **NDALOHET** të paditurit – kundërshtarit të sigurimit Q. K. nga, që ti tjetërsoj, shfrytëzoj dhe ti dëmtoj pjesët e paluajtshmërive P-71107016-01257-0, 01268-0, 01269-0, 01270-0, 01271-0, 01400-0, 01401-0, 01402-0, 01405-0, 01407-0, 01408-0, 01412-2, 01485-0, 01389-0, 01390-0 dhe 01192-0, të cilat gjinden në fshatin Gmicë, Komuna e Kamenicës, dhe atë deri në vendosjen përfundimtare të kësaj çështje juridike kontestimore.

II. DETYROHET Zyra për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, në Komunën e Kamenicës dhe Oda e Noterëve të Kosovës, që ndalimin nga pika 1 e dispozitivit të këtij aktvendimi, ta evidentojnë në regjistrat përkatës të tyre.

A r s y e t i m

Paditësit – propozuesit e sigurimit I.K. dhe R. K., që të dy nga të cilët me autorizim i përfaqëson Selmon Sadiku, avokat nga Kamenica, më datën 08.05.2024, në këtë gjykatë ka paraqitur padi për anulimin e kontratës së dhurimit të paluajtshmërive LRP.nr.077/24, me vlerë të kontestit prej 4.900.00 euro sëbashku me propozimin për caktimim e masës së përkohshme të sigurimit, kundër të paditurit – kundërshtarit të sigurimit Q. K. nga

I autorizuari i paditësit – propozuesit të sigurimit, avokati Selmon Sadiku, përmes propozimit të lartëcekur ka kërkuar nga gjykata që ta caktoj masën e përkohshme të sigurimit, ngase sipas të njëjtit janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 297 dhe 300, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, tutje ka shtuar se egziston rreziku se pa caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, i padituri – kundërshtari i sigurimit, do t’ua bëjë të pamundur paditësve – propozuesve të sigurimit realizimin e të drejtës së tyre me padi, sepse egziston rreziku i shitjes së ngastrave kadastrale kontestuese të cekura sikurse në petitumin e padisë, ngase sipas të njëjtit i padituri – kundërshtari i sigurimit, është në negociata për ta shitur pyellin, si dhe egziston rreziku i dëmtimit të vazhdueshëm të parcelave kontestuese të cekura si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e pas të gjitha këtyre ka theksuar se paditësit – propozuesit e sigurimit me provat e prezentuara e kanë argumentuar besueshmërinë e kërkesës së tyre dhe rrezikun real, ashtu që i ka propozuar gjykatës që të caktohet masa e përkohshme e sigurimit dhe ti ndalohet të paditurit – kundërshtarit të sigurimit, tjetërsimi, shfrytëzimi dhe dëmtimi i pjesëve kontestuese të parcelave të cekura si në dispozitiv të këtij aktvendimi, dhe atë deri në vendosjen përfundimtare të kësaj çështje juridike kontestimore.

Gjykata, e shqyrtoi me kujdes propozimin e paditësit– propozuesit të sigurimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit dhe pas analizimit të provave materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka ardhur në përfundim se propozimi i palës paditëse – propozuese të sigurimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, është i bazuar.

Me nenin 306.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), është paraparë se *“Me propozim të propozuesit të sigurimit të paraqitur me propozim për caktimin e masës së sigurimit gjykata mund ta caktojë masën e përkohshme të sigurimit pa njoftim dhe dëgjim paraprak të kundërshtarit të sigurimit, po që se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshëm pretendimin se masa e sigurimit është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe do të humbte qëllimi i masës së sigurimit”*. Ndërsa me nenin 306.2 të LPK-së, është paraparë se *“Vendimin nga paragrafi 1 të këtij neni gjykata ia dërgon kundërshtarit të sigurimit menjëherë. Kundërshtari i sigurimit brenda afatit prej tre (3) ditësh në përgjigjen e tij mund t’i kontestojë shkaqet për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, e pas kësaj gjykata duhet të caktojë seancë në tri ditët e ardhshme. Përgjigja e kundërshtarit të sigurimit duhet të përmbajë pjesën arsyetuese”*. Po ashtu me nenin 300 të LPK-së është paraparë se *“Për sigurimin e kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij mund të caktohen disa lloje të masave të sigurimit”*, ndërsa me nenin 304.3 të LPK-së, është përcaktuar se, mes tjerash, *“Propozuesi në propozimin e tij duhet t’i tregojë edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim”*, si dhe që këto *“mjete provuese t’ia bashkëngjisë propozimit”*.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se propozimi i palëve paditëse – propozuese të sigurimit, për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, për momentin është i bazuar, nga fakti se ekziston rreziku që pa caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, paditësve – propozuesve të sigurimit do t’iu vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës së tyre, të paraparë me nenin 297.1 pika b), përkatësisht ka konstatuar ekzistimin e rrezikut real se pa caktimin e masës së propozuar, parcelat kontestuese, do të mund të tjetërsohen pasi që i padituri tani më këto parcela

kontestuese i ka të evidentuara në emrin e tij në Zyrën Kompetente Kadastrale, apo në çfardo mënyrë tjetër të dëmtohen. E duke i pasur parasysh të gjitha këto, konstatohet se ka rrezik se pa caktimin e masës së këtillë, pala kundërshtare do të mund t'ua pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e të drejtës së tyre, dhe egziston rreziku tjetërsimit apo dëmtimit të vazhdueshëm të parcelave kontestuese të cekura si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesve të sigurimit, përkatësisht paditësve.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata e aprovoi propozimin e palës paditëse – propozuese të sigurimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, pasi vlerësoi se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 297.1 të LPK-së, për tu caktuar një masë e tillë.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 306 të LPK-së, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORË NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË

Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil

C. nr. 444/2024, i datës 10.05.2024

G j y q t a r i

Artan Abazi, d. v

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, kundër propozuesi i masës së përkohshme të sigurimit – i padituri, ka të drejtën e deklarimit të kundërshtimit brenda afatit 3 (tre) ditor, pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi. Kundërshtimi i deklaruar nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi dhe i njëjti i dorëzohet kësaj gjykate.